

URDHËR
Nr. 118, datë 2.3.2023

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR FUNKSIONIMIN E KLINIKËS DHE TË SPITALIT VETERINAR”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 114, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për funksionimin e klinikës dhe spitalit veterinar”, sipas tekstit bashkëlidhur.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Drejtoria e Politikave Veterinare në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe çdo njësi private dhe shtetërore e licencuar për aktivitetet e klinikës apo spitalit veterinar në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ky urdhër hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

RREGULLORE
PËR FUNKSIONIMIN E KLINIKËS DHE TË SPITALIT VETERINAR

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregullat, kërkesat dhe standardet për kryerjen e veprimtarisë së praktikës mjekësore veterinare për funksionimin e klinikës ose të spitalit veterinar.

Neni 2
Përkufizime

Të gjithë termat e përcaktuar në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me ata të përcaktuar në nenin 4, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Për efekt të kësaj rregulloreje, termi mëposhtëm ka këtë kuptim:

“Klinikë veterinare” dhe **“spital veterinar”** është njësi e shërbimit veterinar privat, që kryen veprimtari të praktikës mjekësore veterinare në një territor të caktuar të njësisë administrative në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3
Kryerja veprimtarisë dhe licencimi i klinikës ose i spitalit veterinar

1. Klinika veterinare ose spitali veterinar kryejnë veprimtari të praktikës mjekësore veterinare, pasi të kenë licencuar aktivitetin e tyre. Licencimi kryhet sipas përcaktimeve të nenit 137, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të

ndryshuar; VKM-së nr. 538, datë 26.5.2009, “Për licencat, lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet (QKL) dhe disa rregullave të tjera, nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar.

2. Klinika ose spitali veterinar i licencuar regjistrohet në regjistrin zyrtar të Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB).

3. Në klinikën ose spitalin veterinar, të drejtën për të kryer veprimtari e ka çdo mjek veterinar i diplomuar, sipas kërkesave të nenit 108, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të jenë të regjistruar në Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 113/2015, “Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar”.

4. Në një klinikë veterinare punësohet jo më pak se 1 mjek veterinar, ndërsa në një spital veterinar punësohen jo më pak se 3 mjekë veterinarë.

Neni 4

Kushtet sanitaro-veterinare të klinikave ose të spitaleve veterinare

Klinika ose spitali veterinar ushtron aktivitet në ambiente të pajisura me dokumentacionin përkatës të cilësuar në VKM-në nr. 538, datë 26.5.2009, “Për licencat, lejet që trajtohen nëpërmjet QKB-së dhe disa rregulla të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar. Ato duhet të jenë të vendosura në ambiente që të garantojnë të gjitha kushtet urbanistike për mirëfunksionimin e tyre, si dhe të garantojnë mirëqenien e kafshëve gjatë trajtimit. Klinika ose spitali veterinar nuk duhet të jetë një ambient shqetësimi për ambientin urban, si dhe në raste të shfaqjes së një infeksioni të rrezikshëm, në ambientet e lokaleve ose në kafshët e trajtuara, sëmundja të jetë lehtësisht e izolueshme.

Ambienti i klinikës ose të spitalit veterinar përveç garantimit të funksionimit normal duhet të plotësojë kushtet higjieno-sanitare, për mospërhapjen e infeksioneve, izolimin e kafshëve me rrezikshmëri të lartë, si më poshtë:

Klinika ose spitali veterinar, duhet:

- a) të jetë e/i pajisur me ujë të rrjedhshëm të ngrohtë dhe të ftohtë;
- b) të ketë dysheme të tillë që të lejojë pastrimin, larjen, dezinfektimin e mirë dhe të shpejtë;
- c) të sigurojë një rrjedhje të mirë të ujërave dhe të mbeturinave ujore të tjera;
- ç) muret e sallave duhet të jenë të veshura me pllaka majolike, kryesisht me ngjyrë të bardhë, që të sigurohet larja e vazhdueshme dhe mbajtja e një pastërtie të mirë;
- d) të sigurojnë rrjeta mbrojtëse në dritare kundër insekteve;
- dh) të ketë ajër të përshtatshëm dhe të ventluar;
- e) të ketë ndriçim natyral dhe artificial;
- ë) të jetë e siguruar, që në objekt nuk mund të hyjnë persona të paautorizuar;
- f) të jenë të mbrojtura nga drita direkte e diellit, nga lagështira dhe të ketë temperatura normale të kondicionuar;
- g) të ketë një vend të posaçëm për largimin dhe groposjen e mbeturinave, jashtë territorit të klinikës/spitalit ose kontratën me kompani për largimin e mbetjeve;
- gj) të garantojnë sigurinë e kafshës dhe të personelit gjatë kryerjes së mjekimit të kafshës në ambientet e punës;
- h) të ketë ambiente të veçuara për mbajtjen dhe ruajtjen e dezinfektantëve, dizisektantëve dhe deratizuesve;
- i) të ketë ambiente të veçanta për mbajtjen e barnave narkotike, psikotrope, si dhe helmet në një vend të shënuar dhe të sigurt dhe të PMV-ve me përdorim të kufizuar dhe me recetë.

Neni 5

Mjediset e veçanta të klinikave dhe të spitaleve veterinare

Ambientet e klinikës ose spitalit veterinar duhet të kenë një sipërfaqe mjedisore të tillë, ku të respektohet ndarja e ambienteve, si më poshtë:

a) **Ambientin e sallës së pritjes**, i cili shërben për pritjen e pronarit së bashku me kafshën. Në këtë sallë vendosen tabela, të cilat shërbejnë për informim, që paraqesin interes për pronarin e kafshës, si dhe të mbahen dokumentacionet e nevojshme dhe regjistri, sipas shtojcës I të kësaj rregulloreje.

b) **Ambientin e sallës së vizitës dhe të mjekimit**, i cili shërben për vizitën e kafshës. Në këtë sallë ndodhet tavolina e mjekut, skedarë ose kompjuter, sterilizator, frigorifer, dollap për mbajtjen e medikamenteve dhe tavolina e mjekut.

c) Në rastet kur një klinikë ose spital veterinar kryen operacione, **ambienti i sallës së operacioneve** duhet të jetë i veçantë nga ambientet e tjera. Në sallën e operacionit ndodhet tavolina e operacionit, e cila duhet të jetë e përshtatshme për fiksimin e kafshës. Në këtë sallë duhet të ketë dollap dhe tavolinë për mbajtjen e PMV-ve, instrumenteve të sterilizuara, si dhe të garantohen kushtet e asepsisë së sallës.

ç) Klinika apo spitali veterinar mund të ketë edhe një ambient **salle të veçantë** për kryerjen e analizave laboratorike.

d) Klinika apo spitali veterinar duhet të ketë ambient për **tualetin dhe ambient të veçantë për gardërobën e personelit**.

dh) Klinika ose spitali veterinar duhet të ketë **vend dhe mjete të posaçme për largimin e groposjen e mbeturinave**. Këto caktohen jashtë territorit të klinikës apo të spitalit, në vend të përshtatshëm për këtë qëllim, që miratohet, në bashkëpunim dhe me autoritetet e njësive të vetëqeverisjes vendore dhe autoritetet mjedisore.

Neni 6

Veprimtaritë që kryhen në klinikën ose në spitalin veterinar

Në klinikën ose spitalin veterinar, në përputhje me qëllimin e veprimtarisë së tyre, kryhen veprimtaritë e mëposhtme:

a) ekzaminimi i kafshëve të sëmura, nekropsia e kadavrave të kafshëve, duke përcaktuar edhe shkaqet e sëmundjeve ose të ngordhjes së kafshëve, diagnozën e sëmundjeve të caktuara, si dhe trajtimi mjekësor i kafshëve me sëmundje infektive ose joinfektive dhe mbajtja nën vëzhgim e tyre;

b) zbatimi i masave shëndetësore veterinarë për parandalimin, zbulimin, kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve infektive në kafshë;

c) zbulimi dhe raportimi i sëmundjeve infektive ose dyshimet për sëmundje infektive të lajmërueshme;

ç) ndërhyrja kirurgjikale, obstetrike, si dhe procedura të tjera të praktikës mjekësore veterinarë;

d) trajtimi mjekësor për infertilitetin, ndërzimi artificial i kafshëve dhe transferimi i vezëve të fertilizuara (transferimi i embrionit);

dh) dhënia e ndihmës së kualifikuar profesionale për pronarët ose kujdestarët e kafshëve për shëndetin veterinar dhe mbarështimin e kafshëve, me qëllim ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të kafshëve, mirëqenien dhe riprodhimin e tyre;

e) mbajtja e regjistrit të veprimtarive mjekësore veterinarë, modeli i miratuar nga SPV-ja, sipas shtojcës I të kësaj rregulloreje;

ë) dhënia e certifikatave shëndetësore veterinarë për procedura në kafshët e gjalla, me materialin biologjik për ndërzim artificial dhe për vezët e fertilizuara, sipas akteve nënligjore, në zbatim të këtij ligji;

f) identifikimi dhe regjistrimi i kafshëve, sipas akteve ligjore dhe nënligjore;

g) marrja e masave për mbrojtjen e mjedisit, në mënyrë që të parandalojë dhe të kontrollojë përhapjen e sëmundjeve infektive (dezinfektim, dezinfestim, deratizim, dekontaminimin radiologjik).

Detyrimet e mjekut veteriner privat në klinikën ose në spitalin veterinar

Detyrimet e mjekut veteriner janë:

1. Mjeku veteriner në klinikën ose spitalin veterinar kryen aktivitetin e tij në zbatim të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 113/2015, “Për urdhrin profesional të mjekut veteriner”, dhe të gjitha akteve të tjera nënligjore që dalin në zbatim të tyre.

2. Mjeku veteriner dhe personeli që punon në klinikën ose spitalin veterinar, gjatë ushtrimit të veprimtarisë në klinikë ose spital veterinar duhet:

a) të respektojë kushtet e higjienës së pastër dhe të pranueshme për pronarin e kafshëve, duke shërbyer me përparësi apo me uniformë pune, në ambientin ku kryen veprimtarinë;

b) të zbatojë udhëzimet e shërbimit veterinar për profilaksinë, kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve infektive dhe sëmundjeve të tjera në shkallë të gjerë;

c) t’u shërbejë në kohë, me etikë profesionale kërkesave të pronarit të kafshës, në çdo rast, pavarësisht rezultatit të mjekimit;

ç) të garantojë nëpërmjet pajisjeve/mjeteve të posaçme sigurimin e kafshës, të personelit dhe të vetes, gjatë kryerjes së trajtimit të kafshëve në klinikë ose në spitalin veterinar;

d) të njoftojë mjekun veteriner zyrtar, të shërbimit veterinar rajonal më të afërt, për sëmundjet infektive që paraqesin rrezik për kafshët, si dhe për sëmundjet që transmetohen te njerëzit dhe anasjelltas (zoonozat) menjëherë nëpërmjet formularit të raportimit të sëmundjeve;

dh) t’i shpjegojë pronarit të kafshës prognozën e mundshme të sëmundjes; në raste agonie ose në raste patologjie të veçanta pa shpresë shërimi, mjeku veteriner, pasi i shpjegon pronarit gjendjen e pashpresë të kafshës dhe mbasi merr lejen prej tij aplikon aktin eutanazik me produkte mjekësore veterinarë të autorizuar për këtë qëllim; mbasi kryerjes së kësaj procedure përpilon dokumentin përkatës, një kopje e të cilit i jepet pronarit;

e) me kërkesë të pronarit të aplikojnë vaksinimet për sëmundjet infektive, që nuk përfshihen në programet e profilaksisë veterinarë;

ë) të plotësojë dokumentacionin përkatës veterinar për çdo produkt mjekësor veterinar të aplikuar, për çdo lloj kafshe për vaksinimet e kryera, dehelmetizimet apo trajtime të ndryshme me medikamente, si dhe të gjitha masat e tjera që ka aplikuar;

f) mban kartelë individuale të kafshës, që i nënshtrohen trajtimit prej tij, në të cilën regjistrohen të dhënat e identifikimit dhe trajtimit të kryer;

g) të kryejë kontrollin, pas ngordhjes së kafshëve, në rastet kur lejohet nga rregulloret përkatëse, të marrë mostra dhe t’i dërgojë në laboratorin veterinar për analiza për konfirmimin e diagnozës;

gj) të njoftojë pronarin ose kujdestarin e kafshëve të prodhimit për kohën e pezullimit të PMV-ve ose për efektet shëndetësore të ushqimeve të medikuara të kafshëve;

h) të mbajë regjistrin e trajtimeve terapeutike dhe profilaktike të kryera në klinikën ose spitalin veterinar, sipas shtojcës I;

i) t’i dërgojë, çdo muaj, shërbimit veterinar rajonal të dhënat për pasaportat mjekësore veterinarë, të lëshuara për kafshët e shoqërimit, të regjistruara;

j) t’i dorëzojë veterinerit zyrtar ose inspektorit veterinar, me kërkesën e tyre, dokumentacionin e mbajtur në klinikë ose spitalin veterinar;

k) t’i dorëzojë shërbimit veterinar rajonal një raport për reaksionet e papritura dhe të rënda, të vërejtura në njerëz dhe në kafshë pas përdorimit të PMV-ve;

l) të lëshojë receta dhe të respektojë kërkesat për përdorimin e produkteve hormonale, beta-agonistëve dhe tireostatikëve ose PMV-ve dhe të lëndëve të tjera, për qëllime mjekësore dhe zooteknike, në kafshët e prodhimit, sipas legjislacionit në fuqi;

ll) të lëshojë librezën/pasaportën e masave profilaktike të kryera në kafshët e shoqërimit për lëvizjen e tyre jashtë territorit të vendit/shtetit;

m) të zbatojë kërkesat e praktikës mjekësore veterinarë dhe të respektojë etikën profesionale gjatë ushtrimit të profesionit.

Neni 8

Veprime që bien ndesh me mirëqenien e kafshëve në klinikat ose në spitalet veterinarë

Për mbrojtjen e mirëqenies së kafshëve ndalohet kryerja e veprimeve të mëposhtme:

a) shkaktimi i torturës, dhunës fizike dhe verbale, sjelljes çnjerëzore, frikës, dëmtimit, dhimbjes, vuajtjes, shqetësimit ose ankthit;

b) grumbullimi i kafshëve në një mënyrë që u shkakton atyre dhimbje, vuajtje ose dëmtim;

c) mbarështimi i kafshëve në errësirë të plotë dhe të përhershme ose të lidhur gjithë kohës;

ç) strehimi në një vend i llojeve të kafshëve të papajtueshme me njëra-tjetrën ose i kafshëve të të njëjtit lloj, kur ky mund të çojë në rritje të agresivitetit, stresit dhe tensionit;

d) kryerja e trajtimeve mjekësore veterinarë dhe dhënia e PMV-ve nga persona pa kualifikimin e duhur;

dh) përdorimi i substancave anestetike ose i substancave që dëmtojnë shëndetin e kafshëve, me përjashtim të rasteve, kur justifikohen në aspektin mjekësor ose për trajtime, në kuadrin e zbatimit të një eksperimenti, të miratuar nga autoriteti kompetent;

e) përdorimi i substancave stimuluese për kafshët, me qëllim arritjen e rezultateve të larta në sport;

ë) ndërzymi natyral ose artificial që rezulton në rrezik ose sjell një rrezik për shëndetin e kafshëve;

f) kryerja pa anestezi e ndërhyrjeve kirurgjikale që shkaktojnë dhimbje në kafshë;

g) transporti i kafshëve në mjete të paautorizuara dhe në kushte që u shkaktojnë atyre dhimbje, dëmtime dhe vuajtje;

Në klinika ose spitalet veterinarë, pronarët e tyre detyrohen të sigurojnë kushte për zbatimin e rregullave të mbrojtjes dhe të mirëqenies së kafshëve.

Neni 9

Kontrollet zyrtare në klinikat ose në spitalet veterinarë

Në mbështetje të nenit 30, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, klinika ose spitali veterinar është objekt i programit të kontrolleve zyrtare të ushtruara nga shërbimi veterinar rajonal, në bazë të protokoll-kontrollit të miratuar me urdhrin e ministrit nr. 651, datë 31.12.2021, “Për miratimin e formateve të protokoll-kontrolleve që kryhen nga veterineri zyrtar”.

Pronari i klinikës ose spitali veterinar është përgjegjës për zbatimin e ligjit dhe akteve ligjore në fuqi, në gjithë aktivitetin që kryen. Për çdo mospërputhje të konstatuar në zbatim të ligjit, ndaj pronarit zbatohen masat, në përputhje me nenet 131 dhe 134, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 10

Detyrimet e pronarëve të klinikave ose të spitaleve veterinarë

Pronari i klinikës ose i spitalit veterinar është i detyruar të zbatojë të gjitha detyrimet e përcaktuara në pikën 1.3, të nenit 134, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 113/2015, “Për urdhrin e mjekut veterinar”.

Neni 11

Detyrimet e pronarëve të kafshëve

Pronarët e kafshëve, që trajtojnë kafshët e tyre në klinikë ose në spitalin veterinar, janë të detyruar të zbatojnë të gjitha detyrimet e përcaktuara në nenin 8, pikën 1 të nenit 19, pikën 1 të nenit 20 dhe nenin 66 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

SHTOJCA I
REGJISTER I MJEKIMEVE MJEKËSORE VETERINARE, PËR KAFSHËT E
KLINIKËS OSE SPITALIT VETERINAR

PLOTESOHET NGA MJEKU VETERINER												
Nr.	Data, Muaji, Viti	Aresya e mjekimit	Seksi	Nr. i kafsheve	Nr. i identifikimit të kafshës	Emri tregtar i PMV / ushqim i medikuar	Koha e pezullimit për shkak të mjekimit	Mjeku Veteriner (Emer Mbiemer)	Nr. i Lotit të PMV-së dhe skadencës e PMV-së të përdorur	Data e Fillimit te Mjekimit	Data e perfundimit te Mjekimit	Furnizuesi i barnave (Emer Adrese)
			Specia									
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
2	/ /									/ /	/ /	
3	/ /									/ /	/ /	
4	/ /									/ /	/ /	
5	/ /									/ /	/ /	
6	/ /									/ /	/ /	
7	/ /									/ /	/ /	
8	/ /									/ /	/ /	
9	/ /									/ /	/ /	
10	/ /									/ /	/ /	
11	/ /									/ /	/ /	
12	/ /									/ /	/ /	

Kuadrat, detyrimisht me numer, mund te perdoren per me teper te dhena ne rastet kur hapsira e faqes se pare nuk mjafton

Veterineri Zyrtar

Data ____/____/____

Vula

Emër Mbiemër, Firmë

Nr. _____ _____ _____ _____ _____	Nr. _____ _____ _____ _____ _____	Nr. _____ _____ _____ _____ _____	Nr. _____ _____ _____ _____ _____
Nr. _____ _____ _____ _____ _____	Nr. _____ _____ _____ _____ _____	Nr. _____ _____ _____ _____ _____	Nr. _____ _____ _____ _____ _____
Nr. _____ _____ _____ _____ _____	Nr. _____ _____ _____ _____ _____	Nr. _____ _____ _____ _____ _____	Nr. _____ _____ _____ _____ _____

Kuadrat, detyrimisht me numer, mund te perdoren per me teper te dhena ne rastet kur hapsira e faqes se pare nuk mjafton

Veterineri Zyrtar

Data ____/____/____

Vula

Emër Mbiemër, Firmë